



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

KONKURS I JASHTËM

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me numër reference: **AUV, 01 - 432/2019**, shpallë të lira këto vende të punës:

1. Titulli i vendit të punës: **Asistent Administrativ - Një (1) pozitë**
Koeficienti: **Gjashtë (6)**
Lloji i pozitës: **I karrierës**

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike, përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve të shpenzimeve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
- Përgatitë dhe modifikon dokumentet, duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe e-malit për mbikëqyrësin;
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit;
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin, si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
- Me kërkesën e mbikëqyrësit kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkathtësitë e kërkuara: (kualifikimi, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkojnë për këtë vend të punës):

- Arsimitim i mesëm, trajnim përkatës dhe së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative,

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Shkathhtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathhtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel).

Procedura e konkurimit:

Procedura e konkurimit është e hapur për kandidat të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kërkesa për plotësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Zona Industriale p.n.

Formularin zyrtar për aplikim mund ta gjeni edhe në Ueb faqen <http://www.auv-ks.org/>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit, duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pa kompletuar me të dhënat e kërkuara, do të konsiderohet i pa vlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës nr. N-107 kati i parë, ndërtesa e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ose me postë.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për shkak të numrit të lartë të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Afati i konkurimit është prej datës **17.09.2019** deri me datë **01.10.2019** në ora **16:00**.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutem na kontaktoni në numrin: 038/ 200-38-304.